



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 56-18/2018 Regjistri (JR)
Datë 24.04.2023

Nr. 48 i vendimit
Datë 11.03.2026

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- sot, më datë 11.03.2026, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen që i përket:

KËRKUES:

Adriatik Cama, përfaqësuar nga avokat Ardian Visha, me Licence nr. 3525, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me adresë: rruga “Abdyl Frashëri”, nd. 17/6 EGT Tower, k. 2, ap. 1, Tiranë, me adresë elektronike: avisha@lawyer.com.

OBJEKTI:

1. Rishikimi i vendimit nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 494 i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e kërkesit në kërkesën për rishikim, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dëgjoji gjyqtaren relatore të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Adriatik Cama (në vijim “kërkuesi”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), pas hetimit administrativ të zhvilluar, me vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), i cili, pas shqyrtimit të ankimit të paraqitur prej tij, me vendimin nr. 5, datë 18.02.2019, vendosi: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama*.
3. Në vendimin nr. 5, datë 18.02.2019, Kolegji ka çmuar se në këtë proces të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit (Adriatik Cama), për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *“[...] ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”*. Ndërsa, për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit: *“[...] nuk u provua të jetë në kushtet e nenit 61, pika 3 e nenit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, e gjen të drejtë pretendimin e tij se nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës”*. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit ka çmuar se vendimi i Komisionit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.
4. Në vijim, kërkuesi, më datë 24.04.2023, ka paraqitur në Kolegji kërkesën me objekt rishikimin e vendimit (JR) me nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit, në të cilën ngre pretendime lidhur me praninë e ish-gjyqtarit L. D., në përbërjen e trupit gjykues që shqyrtoi çështjen e tij në Kolegji.

II. Pretendimet e kërkuesit

5. Kërkuesi ka parashtruar se ka marrë dijëni më datë 21.03.2023 për deklarimin fajtor të të pandehurit L. D., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim, sipas vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë¹. Në këto kushte, bazuar në nenet 494-501 të Kodit të Procedurës Civile, i drejtohet Kolegjit me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, konkretisht vendimin nr. 5 (JR), datë 18.02.2019, të Kolegjit.

¹ Vendimi i datës 21.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë dhe të apelit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, ka gjetur fajtor të pandehurin L. D., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar në nenin 186/1 të Kodit Penal dhe ka dhënë dënimin me 6 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {***}, datë 08.03.2021.

6. Sipas kërkesit, vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë i datës 21.03.2023, përbën rrethanë të re, në kuptimin e nenit 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile, pasi përfundimisht vendosi mbi fajësinë e z. L. D. për falsifikimin e dokumenteve. Fakti i falsifikimit të dokumenteve nga z. L. D. nuk dihej dhe nuk kishte mundësi të dihej nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të ankimit në Kolegj, për sa kohë përbën një fakt penal, i cili duhej vërtetuar në proces gjyqësor dhe me vendim të formës së prerë. Realiteti i të dhënave mbi jetëshkrimin e z. D. do të pamundësonte zgjedhjen dhe emërimin e tij anëtar të një organi kushtetues, siç është Kolegji i Posaçëm i Apelit.
7. Gjithashtu, kërkuesi ka parashtruar se mundësia rishikuese është njohur edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), me vendimin nr. {***}, *Besnik Cani kundër Shqipërisë*. Në atë rast, GjEDNj-ja ka vendosur në mënyrë unanime se ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), në lidhje me të drejtën e kërkesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

i) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: (a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.
9. Në vijim të sa më sipër, i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
10. Kolegji, në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkesit A. Y., ka arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtuar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej, në këtë vendim, ka arsyetuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplicit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkesit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit

nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohej ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkuesi.

11. Në vijim të sa më sipër, në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Trupi gjykues i Kolegjit, në vendimet e marra, lidhur me shqyrtimin e kërkesave të ngjashme për rishikimin e vendimeve të Kolegjit², ka arritur në konkluzionin se Kolegji nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti, sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
12. Në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku me mekanizmat e saj zbatues, garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42 të Kushtetutës.
13. Parashikimi i nenit F, pika 8³ e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të konventës dhe protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilën edhe Shqipëria është palë.
14. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në germën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur GjEDNj-ja gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, po ashtu edhe gjykatat me juridiksion specifik, siç është Kolegji. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jovendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e

² Vendimet i Kolegjit nr. 9, datë 28.02.2025; nr. 10, datë 28.02.2025; nr. 18, datë 08.05.2025; nr. 19, datë 08.05.2025.

³ Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GjEDNj.

interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

15. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 germa e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.
16. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të kërkesës së kërkuesit Adriatik Cama, me objekt rishikimin e vendimit të Kolegjit, verifikoi aspektet formale të kërkesës për rishikim, duke e fokusuar analizën e tij në sa rezulton nga kuadri ligjor, për sa i përket juridiksionit rishikues të Kolegjit, në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në vijim të kësaj analize, në linjë edhe me vendime të mëparshme të tij, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kërkesa për rishikim, objekt shqyrtimi, nuk duhet të duhet të pranohet.
17. Në vendime të mëparshme me objekt kërkimi të njëjtë⁴, nga kërkues të tjerë, trupi gjykues i Kolegjit ka konstatuar, sipas një analize harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit. Ky proces është i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
18. Qëndrimi i mbajtur në deduksion të analizës së bërë më lart i jep përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuesit Adriatik Cama, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim se ajo nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimit që kërkuesi bën në nenin 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile.
19. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit nën dritën e arsytimit të mësipërm, sërish ato, të vlerësuara si *obiter dictum*, konstatohen se janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme⁵ dhe do të vlerësoheshin njësoj si të pabazuara edhe nëse do t’i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor.

⁴ Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A.Y..

⁵ Shih për referencë vendimet (JR) nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkesës së znj. R. G. dhe (JR) nr. 4, datë 15.02.2024, që i përket kërkesës së znj. A. G..

20. Në kushtet që vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D., referohet të jetë kryer vite përpara vendimit dhe nuk ka asnjë ndikim në dhënien e vendimit të kërkuarit, si dhe nuk provohet lidhja shkakësore me vendimin, për të cilin kërkohet rishikimi, e as nuk mund të argumentohet se përbën provë a rrethanë të re, sipas parashikimeve të nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, e as të konsiderohet si shkresë që ka rëndësi për çështjen e rivlerësimit të kërkuarit, ashtu sikurse tashmë është elaboruar në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera.
21. Në konkluzion të sa trajtuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i dhënë për ish-gjyqtarin L. D. nuk përbën as rrethanë dhe as provë të re nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë që i përket çështjes së rivlerësimit të kërkuarit.
22. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa për rishikim e paraqitur prej kërkuarit Adriatik Cama nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Adriatik Cama, për rishikimin e vendimit nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall në Tiranë, më datë 11.03.2026.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 48, datë 11.03.2026, për çështjen nr. 56-18/2018 regjistër (JR) datë 24.04.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuetit Adriatik Cama, për rishikimin e vendimit nr. 5 (JR), datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuetit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkueti A. Y.⁶.
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z. Adriatik Cama, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafët 19 dhe 20 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁶ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-A.-Y._perفشire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 48, datë 11.3.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Adriatik Cama për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 5 (JR), datë 18.2.2019, të Kolegjit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës, por kam ndarë mendim paralel sa i përket qëndrimin të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues⁷ të Kolegjit për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494⁸, shkronja “c”⁹ të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente në mendimet paralele dhe qëndrimin e mbajtur prej meje në kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuarit A. B., A. Gj., F. L., L. K. dhe në mendimin e pakicës ndaj kërkesës së kërkuarit R. T..
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të posaçëm për kërkuarin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjeti i brendshëm të mos jetë efektiv¹⁰ dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13¹¹ të KEDNj-së.
5. Në lidhje me kërkesën e kërkuarit Adriatik Cama, paraqitur më 24.4.2023, rezulton se: (i) shkak për rishikim, sipas pretendimit të kërkuarit përbën vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e “rrethanës së re” në kuptim të nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile,

⁷Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupës gjyqësore në vendimin nr. 12, datë 19.4.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjyqësor.

⁸Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] (c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjyqësor, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; [...] (ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirisë themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

⁹Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarit R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

¹⁰Çështja “Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. 36813/97) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925>”.

¹¹Neni 13 i KEDNj-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

pasi përfundimisht vendosi mbi fajësinë e z. L. D. për falsifikimin e dokumenteve; (ii) kërkesa paraqitet brenda afatit 30-ditor nga marrja dijani (20.04.2023); (iii) “prova e re” përmban të gjitha elementet e domosdoshme për vlefshmërinë e saj.

6. Sa i përket kësaj kërkesë, vlerësoj se nuk përbën shkak për rishikim dhe nuk duhet të pranohet pasi kërkesa për rishikim të një vendimi të formës së prerë sipas germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kushtëzohet nga përmbushja e kriterit sipas të cilit *zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj*. Nga leximi sistematik i germës “a” të nenit 494 të Kodit dhe në harmoni me pjesët e tjera, deduktohet që provat e rrethanat e reja që parashtrohen si shkak për rishikimin, do duhet të jenë të një natyre e cila, nëse do të njëhej prej gjykatës, do të passillte një vendim tjetër.
7. Në vlerësimin tim, vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë¹² nuk mund të konsiderohet në cilësinë e “rrethanës së re” dhe të mundësojë rishikimin e vendimit të formës së prerë të kërkuarit, në kushtet kur në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në shkronjën “c”, qartazi është parashikuar një rrethanë që përbën shkak rishikimi e që lidhet drejtpërdrejt me atë që kërkuari e pretendon si “rrethanë të re”, sipas shkronjës “a” të këtij neni.
8. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon rregullime shumë të detajuara dhe në mënyrë shteruese për rastet e kërkesave për rishikim. Në këtë kuptim, për sa kohë është e parashikuar qartësisht në shkronjën “c” kryerja e një veprë të dënueshme penalisht nga një anëtar i trupit gjykues, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk mund të kualifikohet si rrethanë e re nën shkronjën “a” e, për pasojë, kërkuari i është referuar në mënyrë të gabuar kërkit të tij.
9. Parë në këndvështrimin që, nëse kërkesa do të ishte paraqitur sipas shkronjës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, ndaj vlerësimin tim, në koherencë me qëndrimet e mëparshme, se kërkesa do të përbente shkak për rishikim dhe do të duhet t’i nënshtrohej shqyrtimit.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

¹² Vendimi i datës 21.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë dhe të apelit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, ka gjetur fajtor të pandehurin L. D., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar në nenin 186/1 të Kodit Penal dhe ka dhënë dënimin me 6 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {***}, datë 8.3.2021.

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 48 (JR), datë 11.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: Mospranimin e kërkesës së kërkuetit Adriatik Cama, me nr. {***} prot., datë 24.04.2023, me objekt rishikimin e vendimit nr. 5/2019 (JR), datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por me një arsytim ndryshe, lidhur me arsyet se përse këto kërkesa për rishikim nuk duhen pranuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Siç shihet edhe nga arsytimi i shumicës në vendim, është përdorur e njëjta linjë arsytimi në lidhje dhe me çështjet e tjera që u përkasin kërkesave për rishikim të vendimeve të juridiksionit të rivlerësimit. Më konkretisht, jam kundër arsytimit të shumicës [...] *për t'i dhënë përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuetit Adriatik Cama, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim, ndaj kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkueti bën në nenin 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile. Sipas analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNjsë, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuetit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së [...].*
3. Unë, gjyqtarja me mendim paralel, vlerësoj se në kushtet kur Kushtetuta dhe ligji nuk i ka atribuar Kolegjit juridiksion rishikues, ndaj mendimin se ky institucion nuk mund të ushtrojë këtë tagër/rishikim ndaj vendimeve të tij, kështu që mbetet detyrë pikërisht e ligjvënësit, në kuadër të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke rishikuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore, duke përcaktuar gjykatën kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi